



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 5278 / 13 Prot.

Divjakë, më: 17.06.2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. 39 Datë, 17.06.2025

PËR NDRYSHIME TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 70, DATË 24.12.2024, “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË BASHKISË DIVJAKË, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARTËSI PËR VITIN 2025” DHE NR.71, DATË 24.12.2024, PËR CAKTIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE PËR VITIN 2025.

Mbështetur në pikën ç të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 07.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe ligjin 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.9 datë.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;

Ligjit nr.93 datë 26.07.2024 për një ndryshim të **ligjit nr.35/2023** “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pages bazë minimale në shkallë vendi”;

VKM Nr.328 datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë të punonjësve administrative të njësisve të të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me **VKM Nr.503, datë 01.08.2024**,

VKM Nr.421 datë 26.06.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-ne nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë që në mbledhjen e datës 25.06.2025:

TË MIRATOJË:

1. Ndryshimet në nivelin e pagave për Bashkinë Divjakë sipas lidhjeve të bashkëlidhura dokumentit.
 - Lidhja nr.1 Nivelet e pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësve civilë dhe të punonjësve administrative, punonjësve të profesioneve të ndryshme që ushtrojnë një funksion publik.
 - Lidhja nr.2 Nivelet e pagave për funksionet e deleguara të transferuara nga pushteti qendror në atë vendor.
2. Pagesa e kryepleqëve propozojmë të jetë 9% e pagës se Kryetarit të Bashkisë.

Efektet financiare propozohet të fillojnë nga data 01.06.2025.



Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit Ascteve
Andi BULLARI

Drejtore e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
Eneida Davidhi

Drejtore e Financës dhe Buxhetit
Xheladin BRAHKOLA

KRYETARI

JOSIF GORREA



LIDHJA NR.1

Nivelet e pagave në këtë lidhje janë trajtuar me VKM Nr.328 datë 31.05.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë të punonjësve administrative të njësive të të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM Nr.503, datë 01.08.2024. Kjo lidhje ndryshon Lidhjen nr.1 të Vkb nr.70, datë 24.12.2024.

Nr.	Emërtimi	Arsimi	Kategoria	Klasa	Paga për Pozicion (Ishte)	Paga për Pozicion (Bëhet)
1	Sekretar i Kryetarit	Lartë	IV	IV-4	40,000	60,000
2	Sekretar i Këshillit	Lartë	II	II-2	90,000	100,000
3	Sekretar i Përgjithshëm	Lartë	I	I-4	120,000	130,000
4	Drejtor Drejtorie (Bujqësisë, Mjedisit, Veterinarisë dhe Pyjeve) (pika 6.B e lidhjes nr.1 të Vkb nr. 70, datë 24.12.2024)	Lartë	II	II-2	85,000	120,000
5	Përgjegjës i sektorit juridik dhe prokurimeve publike dhe menaxhimit aseteve	Lartë	III	III-2	80,000	100,000
6	Specialist jurist	Lartë	IV	IV-1	70,000	75,000
7	Specialist prokurimeve publike (pika 13.A e lidhjes nr.1 të Vkb nr. 70, datë 24.12.2024)	Lartë	IV	IV-2	70,000	75,000
8	Specialist buxheti	Lartë	IV	IV-2	70,000	80,000
9	Specialist inventari të imët dhe mjeteve themelore	Lartë	IV	IV-2	55,000	65,000
10	Punonjës i arkëtimeve publike	Mesëm		pika 10	47,000	51,000
11	Përgjegjës i sektorit të mirëqënies sociale, përkujdesit shoqëror	Lartë	III	III-2	75,000	85,000
12	Specialist shërbimeve sociale Divjakë dhe NJA	Lartë	IV	IV-3	50,000	55,000
13	Specialist shërbimit social dhe projekteve	Lartë	IV	IV-3	50,000	55,000
14	Koordinator vendor për menaxhimin e dhunës në familje	Lartë	IV	IV-3	50,000	60,000
15	Punonjës Social	Lartë	IV	IV-3	50,000	55,000
16	Specialist mbrojtjes fëmijës	Lartë	IV	IV-3	50,000	55,000
17	Punonjës strehimit social	Lartë	IV	IV-3	50,000	55,000
18	Specialist arkive	Lartë	IV	IV-3	55,000	60,000
19	Kryeinspektor IVMT	Lartë	III	III-2	70,000	85,000
20	Administrator (Nj.A. Remas)	Lartë		lidhja nr.8	110,000	120,000

LIDHJA NR.2

Niveli pagës në tabelën 2 është trajtuar me VKM Nr.421 datë 26.06.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-ne nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike". Kjo lidhje ndryshon Lidhjen nr.3 të Vkb nr.71, datë 24.12.2024.

Tabela 1 (Ishte)

Nr.	Emërtimi	Arsimi	Kategoria	Klasa	Paga për Pozicion	Shtesa per kualifikim ose per natyre te vecante pune
I	Sektori Ujitjes dhe Kullimit					
1	Ekonomist	Mesëm		Klasa VIII	44,100	4,000

Tabela 2 (Bëhet)

Nr.	Emërtimi	Arsimi	Kategoria	Klasa	Paga për Pozicion
I	Sektori Ujitjes dhe Kullimit				
1	Ekonomist	Lartë	IV	IV-3	70,000

